

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Rucio Investment S.à r.l. (*Rucio Investment S.à r.l.*), me seli në 5 rue Heienhaff, 1736 Senningerberg, Luksemburg në personin e Andrej Mertel (Andrej Mertelj) , Cesta v Zgornji log 25, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes personit të autorizuar Jasmina Ilieva Jovanoviq, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Keleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 05.07.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Rucio Investment S.à r.l. (*Rucio Investment S.à r.l.*), me seli në 5 rue Heienhaff, 1736 Senningerberg, Luksemburg, me aksionarin ekzistues, Andrej Mertel (Andrej Mertelj), Cesta v Zgornji log 25, 1000 Ljubljana, Slloveni synojnë të marrin kontroll të përbashkët mbi DATALAB Tehnologije d.d. (DATALAB Tehnologije d.d.), një shoqëri aksionare, me seli në rrugën Hajdrihova 28C 1000 Lubjanë, Slloveni, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 13.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Rucio Investment S.à r.l. (*Rucio Investment S.à r.l.*), me seli në 5 rue Heienhaff, 1736 Senningerberg, Luksemburg, me aksionarin ekzistues, Andrej Mertel (Andrej Mertelj), Cesta v Zgornji log 25, 1000 Ljubljana, Slloveni synojnë të marrin kontroll të

përbashkët mbi DATALAB Tehnologije d.d. (DATALAB Tehnologije d.d.), një shoqëri aksionare, me seli në rrugën Hajdrihova 28C 1000 Lubjanë, Slloveni.

Në njoftim, parashtruesit theksojnë se më datë 19.05.2023, Rucio ka marrë një vendim në përputhje me të cilin miraton hyrjen në Transaksion, me kusht që paraprakisht të plotësohen disa parakushte si dhe të plotësohen të gjitha kushtet e Transaksionit dhe dokumentet në lidhje me Transaksionin, në mënyrë të përshtatshme.

Në bazë të synimit të tyre serioz për të hyrë në Transaksion, parashtruesit e njoftimit parashikojnë transaksionin si më poshtë:

Rucio Investment S.a.r.l së bashku me disa nga aksionaret ekzistues të DATALAB Tehnologije d.d. (pa pjesëmarrjen kontrolluese) duke përfshirë Andrej Mertelj, synojnë të bëjnë një ofertë të përbashkët për të marrë të gjitha aksionet e DATALAB Tehnologije d.d. të cilat nuk janë (drejtpërdrejt ose indirekt) në pronësi të tyre dhe në pronësi të personave që veprojnë në bashkëpunim me ta në momentin e shpalljes së ofertës së riblerjes. Pas përfundimit të procesit të marrjes, nëse arrihet pragu prej të paktën 90.00%, Palët synojnë të kryejnë një shitje të detyruar (*squeeze-out*) të aksionarëve të pakicës në kompaninë e synuar.

Si rezultat i Transaksionit, Rucio Investment S.a.r.l. do të fitojë kontroll të përbashkët së bashku me Andrej Mertelj mbi DATALAB Tehnologije d.d. dhe shoqërive të saj të varura

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Aktiviteti i biznesit të Rucio Investment S.a.r.l. përfshin:

-zotërim të aksioneve në çfarëdo forme në kompanitë në Luksemburg dhe në kompani të huaja, partneritete ose subjekte të tjera,

-fitim nëpërmjet blerjes, abonimit ose në ndonjë mënyrë tjetër, dhe transferimi me shitje, shkëmbim ose në ndonjë mënyrë tjetër të aksioneve, obligacioneve, kartëmonedhave dhe letrave të tjera me vlerë të çdo lloji dhe

-blerjen, zotërimin, administrimin, zhvillimin, menaxhimin dhe disponon me portofolit e saj.

Rucio Investment S.a.r.l. mund të lidhë të gjitha marrëveshjet në lidhje me blerjen, abonimin ose menaxhimin e instrumenteve të mësipërm dhe financimin e tyre Rucio Investment S.a.r.l. është në pronësi të Imker Holding SARL (*Imker Holding SARL*), 5 rue Heienhaff, 1736 Senningerberg, Luksemburg, e cila është kompania mëmë e Grupit Imker, aksioneri më i madh i së cilës me interes ekonomik (indirekt) prej 40% është LRJ Ridder van Rappardt (*LRJ Ridder van Rappard*), person fizik.

Grupi Imker (duke përfshirë Rucio Investment S.a.r.l. dhe kompanitë nën kontrollin e LRJ Ridder van Rappart) nuk ka prezencë korporative në Maqedoninë e Veriut. Grupi i Blerësit përmes BR SAS, ku Blerësi ka pjesëmarrje korporative, ka arritur të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes së produkteve për kujdesin e lëkurës dhe produkteve kozmetike.

Andrej Mertel nuk ka një pjesë kontrolluese në asnjë shoqëri tjetër përveç në lidhje me aksionet që zotëron në DATALAB Tehnologije d.d. dhe Datalab Agro d.d. Datalab Agro d.d. është një subjekt i ndryshëm nga DATALAB Tehnologije d.d. , e cila nuk ka qenë aktive në 4

vitet e fundit. Nuk ka asnjë pronësi të kryqëzuar apo lidhje tjetër ndërmjet këtyre dy shoqërive.

DATALAB Tehnologije d.d. është një aktivitet biznesi i regjistruar: lëshim i një softueri tjetër. Aksionet e DATALAB Tehnologije d.d. kuotojnë në bursën e Lubjanës. DATALAB Tehnologije d.d. është e pranishme përmes shoqërive të saj të varura në pronësi të drejtpërdrejtë në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, ndërsa produktet e Datalab janë të pranishme në Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë përmes kompanive të lidhura me DATALAB Tehnologije d.d. .

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut DATALAB Tehnologije d.d. ka një shoqëri të varur të saj, Shoqëria për projektim dhe zhvillim të sistemeve informatike DATALAB MK SHPKNJP Shkup, me seli në BulevarDIN 8-të Shtatori nr.2/2-5, Shkup, me aktivitet prioritar të regjistruar: aktivitete konsulente kompjuterike.

DATALAB Tehnologije d.d. së bashku me shoqërit e saj të varura ofrojnë zgjidhje të TI të biznesit për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla. Produkti kryesor është softueri i biznesit që mbështet funksionet kryesore të biznesit të nevojshëm për të menaxhuar në mënyrë efektive biznesin në nivel ndërmarrjeje ose dege, të tilla si menaxhimi i financave të kompanisë, automatizimi i funksioneve të shitjeve dhe marketingut të kompanisë ose menaxhimi i burimeve të përfshira në projektet e korporatës.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски